

Gjykata e Qarkut ne Mitrovicë
P nr.31/09
27 Maj 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Charles Ll. Smith III si gjyqtar kryesues, dhe gjyqtarët e EULEX-it: Hajnalka Veronika Karpati dhe Nicolay Entchev si anëtarë të trupit gjykues, të asistuar nga zyrtarja juridike e EULEX-it Tara Khan si proces-verbal mbajtëse, në lëndën penale kundër

Remzi Rushitit dhe Ajshe Velija, të akuzuar sipas aktakuzës PP nr.231/09 të prokurorit publik të Qarkut, Zjazi Rexha, të datës 11 shtator 2009 e të depozituar në Gjykatën e Qarkut më 14 shtator 2009, për trafikim me njerëz në kundërshtim me nenin 139, paragrafi (1), të Kodit penal të Kosovës (KPK) në bashkim me nenin 23 të KPPK-së;

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me 24,25,26, dhe 27 maj 2010, të gjitha në praninë e të akuzuarve Remzi Rushiti dhe Ajshe Velija dhe avokatëve të tyre mbrojtës Rexhep Kaqaniku dhe Fatmire Braha, prokurorit publik të EULEX-it Neeta Amin dhe Burhan Maxhunit si përfaqësues ligjor i palës së dëmtuar [REDAKTUAR]

Pas mbajtjes së shqyrtimit për vendim-marrje të trupit gjykues dhe votimit të mbajtur me 27 maj 2010, në bazë të nenit 392, paragrafi (1) të Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPPK), shpalli publikisht dhe në praninë e të akuzuarve, mbrojtjes, prokurorit publik të EULEX-it Amin dhe përfaqësuesit ligjor Maxhuni, këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **Remzi Rushiti** me pseudonimin “Remi” i biri i Sherif Rushitit dhe Sherife Bicit, i lindur me 13 shtator 1965 në Vushtri, Kosovë, shqiptar i Kosovës, tregtar, i martuar, ka tre fëmijë, në paraburgim që nga 19 qershori 2009 e deri me 15 shtator 2009 e pastaj nën arrest shtëpiak deri me 1 shkurt 2010,

Dhe

E akuzuara **Ajshe Velija** me pseudonimin “Elvana” e bija e Jusuf Velijajt dhe Zarife Spasit, e lindur me 23 qershor 1983 në fshatin Kalimash, Kukës, Republika e Shqipërisë, shtetase e Shqipërisë, kamariere, e divorcuar, ka dy fëmijë, nuk ka dënim më të hershëm, në paraburgim që nga 19 qershori 2009 deri me 21 prill 2010, tani për tani nën masën e raportimit që duhet kryer në stacionin e policisë së Kosovës,

SHPALLEN TË PAFAJSHËM

Sepse nuk ka prova se nga fillimi i 2008 deri me 12 korrik 2009, Remzi Rushiti dhe Ajshe Velijaj e kanë rekrutuar bashkarisht [REDAKTUAR] që të punojë në kafenenë Qarli, duke e shoqëruar Ajshe Velijajn dhe duke u ulur me mushterinjë meshkuj, duke porositur pije të shtrenjta në mënyrë që të rrisin profitin material të kafenesë. Gjithashtu nuk ka prova se Remzi Rushiti e ka rekrutuar [REDAKTUAR] me mashtrim duke i ofruar asaj punë si kamariere në kafenenë Qarli, pastaj duke i gjetur mushterinjë meshkuj për eksploatim seksual me qëllim të përfitimit material.

Prandaj të akuzarit Remzi Rushiti dhe Ajshe Velijaj

Lirohen

Nga akuza se kane kryer veprën penale të trafikimit me njerëz në shkelje të nenit 139, paragrafi (1) të KPPK-ës, në bashkim me nenin 23 të KPPK-ës.

Pasaporta e Ajshe Velijajt do t'i kthehet në bazë të nenit 251 të KPPK-ës.

Në bazë të nenit 103, paragrafi (1) të KPPK-ës, shpenzimet e procedurës penale nën nenin 99, paragrafi 2, pikat (1) deri (5) të KPPK-ës, shpenzimet e nevojshme të akuzuarve, pagesa dhe shpenzimet e nevojshme të avokatëve mbrojtës, si dhe shpenzimet e përkthimit do të paguhen nga burimet buxhetore.

ARSYETIM

A. Rrethanat procedurale

Prokurori publik i Qarkut Nijazi Rexha ka depozituar pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë me 14 shtator 2009 aktakuzën PP nr.231/09 të datës 11 shtator 2009. Aktakuza e akuzon Remzi Rushitin dhe Ajshe Velijajn për vepër penale të trafikimit me njerëz në kundërshtim me nenin 239, paragrafi (1), së bashku me nenin 23 të Kodit penal të Kosovës. Aktakuza është konfirmuar më 29 dhjetor të vitit 2009 me anë të aktvendimit KA nr.75/09. Prokurori publik i EULEX-it Neeta Amin e mori përsipër rastin dhe depozitoi kërkesë që gjyqtarët e EULEX-it ta shqyrtojnë lënden. Gjyqtarët e EULEX-it e morën përsipër lënden me 15 shkurt të 2010. Shqyrtimit kryesor u mbajt me 24, 25, 26 dhe 27 maj 2010.

Fjalët përfundimtare të prokurorit të EULEX-it Neeta Amin, përfaqësuesit të palës të dëmtuar Burhan Maxhunit, të avokatit mbrojtës Rexhep Kaqanikut (për Remzi Rushitin), dhe avokatit mbrojtës Fatmire Braha (për Ajshe Velijaj) u dëgjuan më 27 maj 2010. Po të njejtën ditë u lëshua dhe aktgjykimi me gojë.

B. Kompetenca e Gjykatës

Sipas nenit 23, pika (1) (i) të KPPK-së, gjykatat e qarkut janë kompetente për t'i shqyrtuar lëndet penale që kanë të bëjnë me akuzat për të cilat ligji parasheh dënimin penal prej së paku 5 viteve. Në bazë të nenit 27, paragrafi (1) të KPPK-së, jurisdiksioni territorial i takon asaj gjykate në qarkun e të së cilës pretendohet se është kryer krimi.

Të akuzuarit akuzohen për veprë penale të trafikimit me njerëz sipas nenit 139, paragrafi (1) të KPPK-së i cili është i dënushëm me dënim burgu prej dy deri dymbëdhjetë vite, për më tepër aktakuza pretendon se dy të akuzuarit i kanë kryer veprat penale në Vushtrri vend ky i cili gjendet në Qarkun e Mitrovicës.

Prandaj, Gjykata e Qarkut e Mitrovicës është organ kompetent gjyqësor që të merret me shqyrtimin e kësaj procedure penale. Me 15 shkurt 2010, kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, ka lëshuar vendim që EULEX-i ta marrë përsipër këtë rast duke u bazuar në nenin 3.3 të Ligjit mbi jurisdiksionin, selektimin dhe ndarjen e rasteve gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it (Ligji mbi jurisdiksionin) dhe ua caktoj këtë lëndë gjyqëtarve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës. Prandaj gjyqtarët e EULEX-it të caktuar pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë janë kompetentë që ta gjykojnë këtë rast penal.

Trupi gjykues përbehej prej gjyqtarëve të EULEX-it, Charles Ll. Smith, III si gjyqtar kryesues, dhe gjyqtarët e EULEX-it: Hajnalka Veronika Karpati dhe Nicolay Entchev si anëtarë të trupit gjykues. Asnjëra palë nuk pati kundërshtim lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

C. Dëshmitë që janë paraqitur

Gjatë gjykimit kryesor u dëgjuan këta dëshmitarë:

1. ██████████ (Palë e dëmtuar) me 25 Maj 2010
2. Nexhat Kurti me 25 Maj 2010
3. Faruk Bojku me 26 Maj 2010
4. Policja Luljeta Halili me 26 Maj 2010

Me 26 maj 2010, këto dokumente u shënuan në procesverbal:

5. Deklarata e palës së dëmtuar ██████████ e datës 12 qershor 2009.
6. Deklarata e palës së dëmtuar ██████████ e datës 16 qershor 2009.
7. Deklarata e palës së dëmtuar ██████████ e datës 13 korrik 2009.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 26 maj 2010, të dytë edhe Remzi Rushiti edhe Ajshe Velija dhanë deklaratë dhe iu përgjigjën pyetjeve.

1. Dëshmia e palës së dëmtuar ██████████

██████████ ka dëshmuar se e ka takuar Remzi Rushitin dhe Ajshe Velija kur Ajshe Velija kishte marrë me qira një dhomë në po të njëjtën shtëpi ku edhe ██████████ kishte një dhomë me qira. Ajsha ishte prezantuar te ██████████ si "Elvana". Ajshe Velija i kishte thënë ██████████ se ishte nga Shqipëria, se kishte punuar tek Rushiti si kamariere në kafenenë e tij të quajtur "kafe Qarli", dhe se ajo ishte në marrëdhënje me Rushitin. Ajshe Velija i kishte thënë

██████████ se ishte e mërziur dhe ishte e vetmuar dhe se kishte nevojë për një shoqe. Ajshe Velija e kishte ftuar ██████████ që ta vizitojë atë në kafënë Qarli disa herë. ██████████ kishte shkuar në kafenenë "Qarli" dy apo tri herë. ██████████ dëshmuar se kur ishte në kafe, ishte ideja dhe sugjerimi i Ajshe Velija që ██████████ të ulej me klientë meshkujë të cilët ishin mushterinjë të rregullt të kafenesë dhe të porosiste pije së bashku me ta. ██████████ është ulur me mushterinjë meshkuj disa herë të cilët nuk i njihite dhe ata i kishin porositur asaj pije¹. ██████████ u prezantohet klientëve si shoqe dhe vizitore². Kishte dhe raste herë pas here kur ██████████ nuk kishte dëshirë të ulej me mushterinjë meshkuj në kafe, porse ose Ajshe Velija ose Remzi Rushiti i thonin asaj që të mos frikësohej dhe të ulej me ta sepse ata ishin mushterinjë të rregullt dhe pijet ishin gratis³.

Gjatë një rasti në kafene, ██████████ i kishte dëgjuar pahiri Ajshe Velijajn dhe Remzi Rushitin se do të fitonin më shumë nëse ██████████ do të ulej me mushterinjë. Në po atë rast, Ajshe Velija dhe Rushiti e kishin pyetur ██████████ mos ishte e interesuar të punonte në kafe si kamariere. Që të dytë, edhe Ajshe Velija dhe Remzi Rushiti i kishin thënë ██████████ se nëse punon aty, ata do ta kishin fitimin më të madh nëse do të ulej me mushterinjë për të porositur pije⁴. Ata i kishin thënë asaj se nëse punon në kafene do të merrte 150 euro në muaj dhe banimin do ta kishte falas në banesën mbi kafënë "Qarli" cila ishte pronë e Rushitit. ██████████ ju kishte treguar prindërve të saj për atë ofertë të punës dhe se babai i saj i kishte telefonuar Rushitit duke i thënë atij që t'i rrij larg ██████████.

██████████ ka dëshmuar se nuk kishte punuar kurrë në atë kafe, se nuk kishte marr kurrë ndonjë pagesë për atë se ishte ulur me mushterinjë meshkuj në kafe dhe se nuk kishte marr kurrëfare të hollash as prej Remzi Rushtit e as prej Ajshe Velija. ██████████ gjithashtu ka dëshmuar se nuk e ka njohur ██████████, Nexhat Kurtin e as Faruk Bojkun.

2. Deklaratat e palës së dëmtuar ██████████

Pala e dëmtuar ██████████ nuk është paraqitur në gjykatë në asnjë seancë edhe përkundër asaj se ishte ftuar në mënyrë të rregullt. Sipas prokurorit publik dhe policisë së Kosovës ██████████ nuk jetonte më në shtëpinë e saj dhe përpjekjet për ta gjetur atë ishin të pasuksesshme. Për shkak të zhdukjes së saj, gjykata i kishte futur në procesverbal si të lexuara tri deklaratat e saj të mëhershme të bëra në polici dhe të prokurorit sipas nenit 360, paragrafi (1), pika (1).

Me 12 qershor 2009, ██████████ në polici kishte deklaruar si vijon:

██████████ kishte qenë duke punuar si kamariere në Kafë Qarli pronë kjo e Remzi Rushitit që nga 9 qershori 2009 dhe atë për 6 euro në ditë. Ajo ishte marrë vesh me Remzi Rushitin se do të kryente marrëdhënie seksuale me njerëz që ai do ja sillte asaj. Personi do të paguante 20 euro për seks, 10 euro do i shkonin ██████████ kurse 10 euro Remzi Rushitit. Me 9 qershor 2009 përafërsisht në ora 21.30, një person kishte folur me Rushitin dhe ishin marr vesh se ai do të bënte seks me ██████████ për të holla. ██████████ kishte shkuar me personin në banesën

¹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 maj 2010, faqja 16.

² Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 maj 2010, faqja 9.

³ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 maj 2010, faqja 13-14 dhe 21.

⁴ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 25 maj 2010, faqja 13 dhe 20.

e tij cila gjindej afër akademis policore dhe kishte bërë seks gjatë një ore, gjë për të cilën ajo kishte marrë 10 euro kurse Remzi Rushiti kishte marr dhe ai 10 euro. Të nesërmen, një person tjetër ishte takuar me Remzi Rushitin për të njejtën arsye, mirëpo [REDAKTUAR] kishte refuzuar të bënte seks me [REDAKTUAR] person. Më 12 qershor 2009, [REDAKTUAR] ishte në Kafe Qarli në ora 20.40 kur një zënkë kishte shpërthyer mes dy mushterinjëve, Azem Bojkut dhe birit të tij Faruk Bojkut. [REDAKTUAR] kishte refuzuar të bënte seks me Azem Bojkun dhe si rezultat i kësaj Farku ia kishte ngjitur për dore asaj dhe ishte përpjekur ta godasë atë me një shishe birre. Rushiti kishte intervenuar ta mbrojë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kishte shkuar ne kuzhinë përderisa një rrahje kishte shpërthyer në mes të burrave në kafe. Pastaj ajo kishte shkuar tek banesa e cila gjendje mbi kafene përderisa kishte ardh policia dhe e kishte marr atë në stacion.

Më 16 qershor 2009, [REDAKTUAR] në polici kishte deklaruar si vijon:

[REDAKTUAR] për tri vite me radhë. Javën para se të jepte deklaratën e saj, [REDAKTUAR] dhe Kurti kishin shkuar në Kafe Qarli së bashku. [REDAKTUAR] ishte marr vesh me Remzi Rushitin që ajo të punoj si kamariere për 6 euro në ditë dhe banim falas. Ata gjithashtu ishin marrë vesh se ajo do të bënte seks me mushterinjë dhe se kështu ajo me Remzi Rushitin do t'i ndanin të hollat për gjysmë. Nexhat Kurti nuk ishte në dijenit për këtë marrëveshje. [REDAKTUAR] kishte bërë seks me një mushterinjë me emrin Astrit të quajtur nga Prishtina në një banesë afër Akademisë së policisë. Këta kishin bërë seks një orë dhe ishin kthyer në kafe. Astriti ia kishte paguar Rushitit të hollat për seks dhe ia kishte dhënë 10 euro [REDAKTUAR] duke i thënë asaj "Mbaj këto të holla për seksin me Astritin". Më 12 qershor 2009, Azem dhe Faruk Bojku shkuan në Kafe Qarli dhe [REDAKTUAR] ishte ulur në tavolinë me [REDAKTUAR] ta. Azem Bojku i kishte thënë [REDAKTUAR] se ajo nuk kishte zgjidhje tjetër vec të bënte seks me të. Ajo kishte refuzuar dhe kështu Azemi kishte filluar ta shajë atë. Ajo ishte larguar nga tavolina e tyre dhe kishte shkuar të ulej tek Remzi Rushiti dhe dashnorja e tij "Elvana" (Ajshe Velija). Faruk Bojku ishte përpjekur pastaj ta godas [REDAKTUAR] me një shishe birre kurse Remzi Rushiti kishte ndërhyre. Rrahja kishte shpërthyer mes burrave. [REDAKTUAR] kishte shkuar në banesën lartë përmbi kafe dhe kishte qëndruar aty së bashku me Ajshe Velija derisa kishte arritë policia.

Më 13 qershor 2009 [REDAKTUAR] para prokurorit publik kishte deklaruar si vijon:

[REDAKTUAR] ka deklaruar se i kishte kaluar 4-5 ditë në Kafe Qarli me shoqen e saj, Ajshe Velijajn. Gjatë asaj kohe, ajo kishte kaluar kohën dhe në kafene dhe në banesën përmbi të, duke pasur biseda shoqërore me Ajshe Velijajn dhe Remzi Rushitin. As Ajshe Velija e as Remzi Rushiti nuk i kishin afruar kurrë punë në kafene. [REDAKTUAR] nuk kishte pasur kurrë seks me mushterinj, ajo nuk kishte pasur kurrë seks me një person të quajtur Astrit nga Prishtina, dhe se Remzi Rushiti nuk i kishte dhënë kurrë asaj të holla pas seksit me mushterinjë. [REDAKTUAR] nuk kishte thënë të vërteten në dy deklaratat e saj të mëhershme të dhëna në polici sepse kishte qenë nën presion që ta cekë policën Luljeta Halili.

3. Dëshmia e Faruk Bojkut

Faruk Bojku ka dëshmuar se ka shkuar shpesh në Kafe Qarli, dy apo tri herë në javë dhe se Ajshe Velija të cilën Faruk Bojku e njihje si "Elvana" punonte aty si kamariere. Ai kishte qenë në Kafe Qarli në natën e 12 qershorit 2009, pronari Remzi Rushiti dhe Ajshe Velija kishin qenë të pranishëm. Faruk Bojku e kishte parë babain e vetë Azem Bojku, fqin e tij Shaban Manin, dhe

[REDACTED] të ulur së bashku duke pirë pije në një tavolinë. Faruk Bojku ka deklaruar se [REDACTED] ishte nën ndikimin e alkoholit dhe se ajo e kishte shërbyer atë me pije. Megjithatë, ai nuk e kishte ditur se a punonte ajo aty si kamariere. [REDACTED] ishte ulur me të në një tavolinë për afërsisht 10 minuta. Kishte pasur një bisedë me të dhe kishin pirë nga një pije. Në po atë mbrëmje, Faruk Bojku dhe një mushteri tjetër me emrin Behran ishin zënë sepse ishin nën ndikim të alkoholit dhe i kishin thyer karrigat. Në momentin e zënkës, [REDACTED] qëndronte e ulur në një tavolinë me Behranin dhe Ismetin. Faruk Bojku ka dëshmuar se nuk e njeh [REDACTED] apo personin e quajtur Astrit.

4. Dëshmia e Nexhat Kurtit

Nexhat Kurti ka dëshmuar se e kishte takuar [REDACTED] për herë të parë 3-4 vite më herët kur ajo vinte si mushteri në ëmbëltoreshen e tij dhe më vonë ishin bërë dashnorë. Herë pas here Nexhat Kurti dhe [REDACTED] kishin shkuar për të pirë në Kafe Qarli. Nexhat Kurti ka dëshmuar se Ajshe Velija i kishte kërkuar [REDACTED] që qëndrojë me të në banesën përmbi Kafe Qarli sepse Ajshe Velija frigohej të flinte vetë aty. [REDACTED] kishte qëndruar me Ajshe Velija vetëm një herë por kishte qëndruar për një periudhë dy deri tri ditë. Sipas Nexhat Kurtit, [REDACTED] ishte shumë mirënjohëse ndaj Ajshe Velijaj për arsye se kjo i kishte ndihmuar asaj dhe i kishte dhënë asaj rroba dhe ushqim. [REDACTED] nuk ka punuar kurrë në Kafe Qarli, ajo ka qenë aty vetëm mushteri. Nexhat Kurti ka dëshmuar se nuk e njeh personin me emrin Astrit dhe se kishte parë [REDACTED] vetëm një herë më herët.

5. Dëshmia e Luljeta Halilit

Luljeta Halili është police e cila punon në hetimet që kanë të bëjnë me trafikim me njerëz. Ajo e kishte intervistuar palën e dëmtuar [REDACTED] më 16 qershor 2009 së bashku me kolegun e saj Ferat Rrukollin. Burhan Maxhuni, avokat i [REDACTED] ishte i pranishëm gjatë asaj interviste. Policia nuk kishte përdorur ndonjë presion mbi [REDACTED] dhe se ajo e kishte dhënë deklaratën e saj me dëshirë. As [REDACTED] e as Burhan Maxhuni nuk kishin cekur ndonjë ankesë në lidhje me intervistën apo të kenë thënë se intervista ishte zhvilluar në mënyrë të padrejtë apo të gabueshme. Pas përfundimit të intervistës, policia ia kishte lexuar deklaratën përsëri [REDACTED], dhe [REDACTED] e kishte nënshkruar atë pa presion. Sipas mendimit të Luljeta Halilit, [REDACTED] dukej si viktimë e vërtetë gjatë intervistës. Policia Luljeta Halili më vonë u informua nga prokurori se avokati mbrojtës së bashku me gruan e Remzi Rushitit kishin shkuar te shtëpia e [REDACTED] dhe i kishin kërkuar asaj që ta ndryshonte deklaratën e vet.

6. Dëshmia e dy të akuzuarve

Dëshmia e Remzi Rushitit

Remzi Rushiti e kishte takuar Ajshe Velija në maj 2008. Ai e kishte ftuar atë të punojë si kamariere në Kafe Qarli për 10 euro në javë, një shujtë në ditë dhe banim falas. Ajo ishte pajtuar dhe kishte kaluar në banesën përmbi kafene. Pas një kohe kishin filluar dhe lidhjen e tyre. Remzi Rushiti e njeh Nexhat Kurtin dhe [REDACTED]. Nexhat Kurti dhe [REDACTED] kishin shkuar në Kafe Qarli më 9 qershor 2009 për të pirë. [REDACTED] kishte qëndruar me Ajshe Velija disa ditë sepse Ajshe Velija ndihej e vetmuar dhe kishte frigë. Me 12 qershor

2009, [REDACTED] po pinte së bashku me Faruk Bojku dhe Azem Bojkun në kafene. Ata kishin konsumuar shumë alcohol kurse Azem Bojku kishte deklaruar se [REDACTED] ishte shoqja e tij. Rushiti e kishte dëgjuar pahiri Azem Bojkun duke i thënë [REDACTED] "a të kujtohet kur ti kam këput taket e nalta edhe ta kom fut kryet nën ujë dhe tu mbushke fyti ujë"? Azem Bojku i kishte thënë Remzi Rushitit kishte qenë femra e tij për një kohë të gjatë.

Përkujtimi me dëshminë e [REDACTED] Remzi Rushiti e ka mohuar se Ajshe Velija e ka sjellur [REDACTED] që të punojë për të, se ai kurrë nuk ka deklaruar se do të kishte fitim më shumë pot e ulej [REDACTED] he mushteri, se kurrë nuk e kishte udhëzuar [REDACTED] që të ulej me mushterijtë e tij ose që kurrë nuk i ka dhënë të holla [REDACTED].

Sa i përket dy deklaratave të [REDACTED] dhënë në polici, Remzi Rushiti e ka mohuar kategorikisht se [REDACTED] punuar për atë si kamariere në Kafe Qarli, se kurrë nuk i ka thënë [REDACTED] ti ofroj shërbime seksuale ndokujt, se kurrë nuk ia ka shitur [REDACTED] ndokujt apo që i ka dhënë ndonjëherë të holla [REDACTED]. Remzi Rushiti gjithashtu e ka mohuar ta ketë njohur ndonjë person me emrin Astrit.

Remzi Rushiti ka dëshmuar se përderisa gjindej në paraburgim gruaja e tij e kishte pyetur [REDACTED] se mos Remzi Rushiti e kishte shitur atë dhe se [REDACTED] hte përgjigjur "jo". [REDACTED] pastaj i kishte thënë gruas së tij se e kishte akuzuar Remzi Rushitin për shkak se "ajo kishte qenë e shqetësuar dhe e rrahur në Mitrovicë" pastaj [REDACTED] vullnetarisht i ka tërhequr deklaratat e saja të mëhershme të dhëna në polici.

Dëshmia e Ajshe Velijajt

Ajshe Velija ka dëshmuar se ajo po punonte si kamariere në Prishtinë kur e kishte takuar Remzi Rushitin. Ajo kishte shkuar të punojë si kamariere për të në Vushtrri për arsye se paga ishte më e mirë. Ajo dhe Rushiti filluan të kalonin. Velija ka punuar në Kafe Qarli si kamariere për një vit përafërsisht për 10 euro në ditë. Pastaj ajo u largua dhe shkoi në Prishtinë për një muaj, Rushiti i kishte paguar qiranë e banesës dhe ajo takoi [REDACTED]. Pas një muaji, Velija u kthye në Vushtrri.

Sa i përket [REDACTED] Ajshe Velija ka dëshmuar se [REDACTED] kishte ardhë ta vizitojë atë në Vushtrri për dy tri ditë dhe me vullnetin e saj. Ajshe Velija e ka mohuar ti ketë thënë [REDACTED] se kishte frigë të qëndroj në banesë vetëm. Kur [REDACTED] kishte shkuar të qëndroj tek ajo, ajo ishte ulur nëpër tavolina në Kafe Qarli dhe ishte ulur me shokët e saj dhe jo me të huaj. Ajshe Velija e ka mohuar që ajo dhe Remzi Rushiti t'i kenë thënë [REDACTED] se ajo duhet gjithashtu të punojë në kafe apo se ajo dhe Rushiti kishin diskutuar faktin se nëse [REDACTED] ulet nëpër tavolina fitimi do të ishte më i madhë. Velija gjithashtu e ka mohuar ta ketë rekrutuar [REDACTED] me qëllimin që ajo të bëjë seks me mushterinjtë meshkuj.

Sa i përket [REDACTED] Ajshe Velija ka dëshmuar se e ka njohur [REDACTED] vetëm disa ditë. Ajshe Velija e njihje atë si [REDACTED].

Ajshe Velija ka deklaruar se nuk ka qenë e involvuar në ngjarjet që kishin ndodhur në Kafe Qarli në qershor të vitit 2009. Në atë natë ajo e ka parë [REDACTED] duke pirë alcohol në kafenenë Qarli. Ajshe Velija ka qenë lartë në banesë duke shikuar televizionin kur ka ndodhur incidenti dhe kur policia ka ardhur në kafe. Velija e ka mohuar ta ketë njohur ndonjë person me emrin Astrit.

D. Vlerësimi i dëshmime të paraqitura

Besueshmëria e dëshmitarëve

Gjykata ka gjetur se dëshmia e dëshmitarës [REDAKTUAR] është e besueshme dhe konsistente dhe si e tillë, e përshkon përmbajtjen e përgjithëshme të dëshmisë së saj. Gjykata ka gjetur se edhe dëshmia e Nexhat Kurtit është e besueshme. Meqenëse ai nuk ka qenë dëshmitar në asnjërin prej veprimeve kriminale për të cilat pretendohet, se janë kryer dhe meqenëse ka pasur informata të kufizuara përkitazi me veprimet e [REDAKTUAR] apo [REDAKTUAR] lidhje me Kafën Qarli dëshmia e tij nuk ka shuar asgjë të re në këtë rast.

Gjykata gjithashtu ka gjetur se dëshmia e policës Luljeta Halili është e besueshme. Policia Halili ishte e qartë dhe e drejtëpërdrejt gjatë dëshmisë që po e jepte lidhur me zhvillimin e ligjshëm të të dy intervistave policore të [REDAKTUAR]. Deklarata e Luljeta Halilit përforcohet dhe mbështetet në faktet se: deklarata e 12 qershorit e përmban deklaratën me nënshkrim të [REDAKTUAR] si deklaratë të vërtetë dhe të saktë e cila nuk është dhënë në asnjë ndikim ose presion. Intervista e 16 qershorit 2009 është zhvilluar në praninë e avokatit Burhan Maxham si përfaqësues ligjor [REDAKTUAR], edhe deklarata e intervistës të 16 qershorit 2009 përmban deklaratën me nënshkrimin e [REDAKTUAR] se deklarata është lexuar asaj me zë dhe nuk ka pasur vërejtje. Për këto arsye gjykata nuk ka arsye të dyshoj në ligjshmërinë e intervistave dhe se deklaratat me shkrim janë reflektim i saktë i asaj se cka ka thënë dëshmitarja para policisë.

Megjithatë, vërtetësia e deklaratave të [REDAKTUAR] nuk mund të vërtetohet nga gjykata. Egziston kontradiktë e drejtëpërdrejtë në mes të deklaratave të dhëna në polici dhe deklaratës së 13 korrikut 2009 para prokurorit publik. Përveç kësaj, madje ka edhe mospërputhje në mes të dy deklaratave të dhëna në polici në qershor 2009. Po të ishte paraqitur [REDAKTUAR] në gjykatë dëshmia e saj do ta kishte ndriquar besueshmërinë e njërit apo tjetrit version të deklaratave. Por meqenëse ajo nuk është paraqitur në gjykatë, ka qenë e pamundshme për gjykatën që ta vlerësojë besueshmërinë e dëshmitares dhe se gjykata nuk ka mundur të arrijë te asnjë konkludim sa i përket vërtetësisë së njërës prej tri deklaratave të [REDAKTUAR]. Prandaj, aspektet e deklaratave cilat janë kontradiktore duhet të shikohen në bazë të asaj se cila është më e favorshme për të akuzuarit.

2. Konstatimi i gjendjes faktike

Në bazë të dëshmimeve që janë paraqitur gjatë zhvillimit të gjykimit kryesor gjykata mund të konsiderojë si të dëshmuara vetëm këto fakte:

Ajshe Velija ka punuar si kamariere në kafenenë Qarli, pronë e Remzi Rushitit. Ajshe Velija ka jetuar në banesën e cila gjindej mbi kafene. Ajshe Velija e ka takuar [REDAKTUAR] kur ajo ishte larguar nga Vushtrria dhe kur e kishte marrë një dhomë me qira në po të njëjtën shtëpi në Prishtinë. Pastaj, Ajshe Velija është kthyer në Vushtrri dhe [REDAKTUAR] ka shkuar ta vizitonte atë për disa ditë.

Gjykata beson se ka pasur bisedë në mes të Ajshe Velisë dhe /ose Remzi Rushitit me [REDAKTUAR] përkitazi me punën e saj si kamariere në kafene. Gjykata nuk është e bindur se kjo ka qenë ofertë formale pune. Për më tepër, dy të akuzuarit edhe po ti kishin kërkuar [REDAKTUAR]

se mos dëshironte të punoj në kafe si kamariere, meqenëse nuk ka kurrfarë prove që ndonjëri prej të akuzuarve është përpjekur ta rekrutoj ose ta marr [REDAKTUAR] për të punuar në ndonjë cilësi tjetër pos kamariere ky fakt nuk do të kishte kurrëfarë ndikimi në rezultatin e aktgjykimit.

Gjykata gjithashtu gjen se poashtu nuk ka ndikim në këtë rast apo në aktgjykim fakti se a i ka kërkuar Ajshe Velija [REDAKTUAR] që ta vizitoj atë sepse ishte e frikësuar apo se a e ka vizituar [REDAKTUAR] vullnetin e saj. Me këtë nuk arrihet kurrëfarë konstatimi sa i përket kësaj pike.

Përderisa ishte në kafenenë Qarli, [REDAKTUAR] është ulur nëpër tavolina dhe është shoqëruar me disa mushterinjë cilët kanë porositur dhe kanë paguar pije. Të akuzuarit e kanë ditur faktin se mushterinjtë meshkuj do të hargjesin më shumë të holla në kafe, pije gjatë shoqërimit me [REDAKTUAR].

Gjykata mendon se dy të akuzuarit e kanë pranuar se fitimi në kafene ishte më i madh ku [REDAKTUAR] ulej me mushterinjtë. Sidoqoftë, një gjë e tillë nuk paraqet vepër penale meqenëse është e qartë nga dëshmia e [REDAKTUAR] se ajo ka pasur mundësin ta refuzoj ofertën e punës në kafe dhe se kurrë nuk ka qenë e detyruar me forcë të ulet dhe të shoqërohet me mushterinjtë. Gjatë dëshmisë së [REDAKTUAR], gjyqtarja Hajnalka Veronika Karpati e ka pyetur [REDAKTUAR] në detaje se a është përdorur forcë apo kërcnim kundër [REDAKTUAR] gjatë punës në kafene ose derisa po ulej me mushterinjtë në kafene dhe përgjigjeja ishte se [REDAKTUAR] kurrë nuk është detyruar me forcë që ta bëj një gjë të tillë.

Në mbrëmjen e qershorit 2009, një rrahje kishte shpërthyer në kafenë Qarli ku ishte involvuar Faruk Bojku si rezultat i saj, policia ka shkuar në kafe dhe ka arrestuar Ajshe Velinë. Lidhur me këtë incident nuk ka qenë e mundur që të vërtetohen fakte të tjera. Arsyet e kësaj rrahje duke përfshirë aty se a ka rrjedhur kjo si rezultat i refuzimit të [REDAKTUAR] për të bërë seks me Azem Bojkun, këto arsye nuk mund të vërtetohen për shkak të kontraditave në mes të deklaratave të Faruk Bojkut dhe Remzi Rushitit dhe të deklaratave të ndryshme të [REDAKTUAR] (të cilat janë kundërtëne mes veti dhe në vetvete dhe u mungon besueshmëria për arsyet që u dhanë më lartë).

E. Ligji/ kualifikimi ligjor

Aktet penale pretendohen se janë kryer në qershor 2009. Kodi penal i Kosovës ka hyrë në fuqi me 6 janar 2009 kështu që është ligj në fuqi. Sipas nenit 2, paragrafi (1) të KPPK-ës ligji që ka qenë në fuqi në momentin kur kryhet vepra penale duhet të zbatohet.

Të akuzuarit akuzohen me nenin 139, paragrafi 1 të KPPK-së, trafikim me njerëzit. Trafikim me njerëzit definohet me paragrafin (8) si "rekrutimi, transportimi, transferi, strehimi dhe pranimi i personave nëpërmjet kërcnimit apo përdorimit të forcës apo formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, të mashtrimit, të lajthitjes, të keqpërdorimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të marrjes apo dhënjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit".

Sa i përket palës së dëmtuar [REDACTED]

Dëshmitë e paraqitura gjatë gjykimit e që u përmbledhën më sipër vërtetojnë vetëm se [REDACTED] vullnetarisht ka shkuar në Kafe Qarli ku dhe është ulur në tavolina me mushterijë meshkuj, është shoqëruar me ata dhe ka porositur pije. Siq u përshkrua më sipër nuk ka dëshmi që [REDACTED] ka qenë e detyruar me forcë dhe e shtyer ta kryej ndonjërin prej këtyre akteve. Ajo gjithashtu dhe nuk ka pranuar kurrëfare pagese prej asnjërit të akuzuarve. Për më teper zgjerimi i veprave të Remzi Rushitit dhe Ajshe Velijaj duket se është bërë përshkak të diskutimit të tyre apo pohimit se Remzi Rushiti kishte fitime më të mëdha nga pijet kur [REDACTED] shoqërohej me mushterijtë meshkuj.

Sa i përket palës së dëmtuar [REDACTED]

Përshkak të mosparaqitjes së [REDACTED] në gjykatë dhe mungesës së besueshmërisë të deklaratave të saja kundërthënëse në polici dhe te prokurori dhe përshkak se nuk ka pasur prova tjera mbështetëse dhe sqaruese lidhur me pretendimet që në fillim i kishte bërë [REDACTED] lidhur me aktet seksuale janë këto pretendime të cilat nuk kanë mundur të dëshmoen:

- Se njëri prej të akuzuarve e ka shtyer me forcë ose detyruar [REDACTED] që të ketë marrëdhënje seksuale me ndonjë person.
- Se njëri prej të akuzuarve ka marr të hollat nga ndonjë person i cili ishte lëshuar në marrëdhënje seksuale me [REDACTED].
- Se njëri prej të akuzuarve i ka dhënë të holla [REDACTED] për të pasur marrëdhënje seksuale me ndonjë person.

Kështu nuk është vërtetuar apo konstatuar asnjëri nga *actus reus* të cilat janë kritere për kryerjen e veprës penale të trafikimit me njerëz ose të ndonjë vepër më të vogël penale i cili do të ishte i aplikueshëm sipas KPPK-ës.

Për këto arsye trupi gjykues e ka lëshuar Ajshe Velija dhe Remzi Rushitin nga akuza e trafikimit me njerëz në pajtim me nenin 390(3) të Kodit të procedurës penale të Kosovës.

F. Shpenzimet

Për shkak të lirimit të dy të akuzuarve, në bazë të nenit 103, paragrafi (1) të KPPK-ës, shpenzimet e procedurës penale nën nenin 99, paragrafi 2, pikat (1) deri (5) të KPPK-ës, shpenzimet e nevojshme të akuzuarve, pagesa dhe shpenzimet e nevojshme të avokatëve mbrojtës, si dhe shpenzimet e përkthimit do të paguhen nga burimet buxhetore.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

Pr. nr.31/09

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Mbajtës i procesverbalit

Kryetar i Trupit Gjykses

Tara Khan

Charles L. Smith, III

Anëtare e Trupit Gjykses

Anëtarë i Trupit Gjykses

Hajnalka Veronika Karpati

Nikolay Entchev

Këshillë juridike:

Personat e autorizuar mund të depozitojnë ankesë në formë të shkruar kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data kur kopja e këtij aktgjykimi është pranuar sipas nenit 398, paragrafi (1) të KPPK-së.